

# LegalNews

Nëntor 2017  
November 2017



## I. Projektligj "Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin""

Së fundmi, Këshilli i Ministrave ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, Për Turizmin" (në vijim, "Projektligji").

Projektligji parashikon shtimin e disa dispozitave në ligjin nr. 93/2015, datë 27.07.2015 "Për turizmin" (në vijim, "Ligji"), të cilat synojnë krijimin e lehtësive për nxitjen e palëve të interesuara për të investuar në struktura akomoduese me 4 dhe 5 yje, duke parashikuar, për këtë qëllim, akordimin e "statusit special" për këta të fundit.

Sipas relacionit shoqërues të Projektligjit, i cili argumenton nevojën e miratimit të tij, këto lehtësi për operatorët vendas dhe të huaj, të cilët kërkojnë mundësinë e realizimit të investimeve të mëdha në Shqipëri në sektorin e turizmit elitare, konsistojnë në lehtësimin e një pjese të taksave dhe tatimeve që rëndojnë, aktualisht, mbi këta investitorë.

Sa më sipër, në nenin 1 të Ligjit shtohen përkufizimet si vijon:

- "Strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton strukturën akomoduese që përfshin hotelin dhe/ose resortin me 4 ose 5 yje, e cila përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/2 të Ligjit.

## I. Draft law "On some additions to the law no. 93/2015 "On tourism""

Recently, the Council of Ministers has proposed to the Parliament of the Republic of Albania the draft law "On some additions to law no. 93/2015, "On Tourism" (hereinafter, the "Draft Law").

The Draft Law provides for some additions to law no. 93/2015, dated 27.07.2015 "On tourism" (hereinafter, the "Law"), aiming creation of incentives that would foster the interested parties to invest in 4 or 5 stars accommodating facilities, by setting out, to such purpose, the awarding of a "special status" to them.

According to the accompanying report of the Draft Law, which arguments on the necessity of the enactment thereof, such incentives, for domestic and foreign investors, who are seeking the opportunity to made major investments in Albania in the sector of luxury tourism, consists on the partial reduction of taxes currently payable by such investors.

As per the above, article 1 of the Law is supplemented by the following definitions:

- "4 or 5 stars accommodation facility, special status" means the accommodation facility consisting of 4 or 5 stars hotel and/or resort, which fulfills the criteria set forth in Article 33/2 of the Law.

- "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton subjektin i cili financon ndërtimin dhe/ose merr përsipër ndërtimin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/1 të Ligjit.
- "Operator menaxhues në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton grupin hotelier i cili merr përsipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kontratave "franchising" apo kontratave të tjera të ngjashme me këtë të fundit.

Më tej, Projektligji përmban kushtet kryesore lidhur me dhënien e statusit "Investitor në strukturën akomoduese me 4 dhe 5 yje, status special", për subjektet përkatëse. Ky status jepet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, për subjekt që plotëson kushtet si më poshtë:

Të jetë investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë, të çertifikuar si të tillë nga struktura përgjegjëse sipas këtij Ligjit.

Vlera e investimit të jetë të paktën 8 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 milionë euro për ndërtimin e atyre me 5 yje.

- "Investor in 4 or 5 stars accommodation facility, special status" means the entity who finances the construction and/or undertakes the construction of 4 or 5 stars accommodation facilities, special status, in the areas having as priority the tourism development, which fulfills the criteria set out in Article 33/1 of the Law.
- "Managing operator of 4 or 5 stars accommodation facility, special status" means the hotel group that undertakes the operation and management of a 4 or 5 stars accommodation facility, special status, directly or through "franchising" contracts or other agreements similar to the latter.

Furthermore, the Draft Law contains the main criteria on awarding of the status of "Investor in 4 or 5 stars accommodation facility, special status", to the respective entities. Such status is granted by the Council of Ministers, upon proposal of the ministry responsible for tourism, to any entity that meets the following conditions:

The entity is investor in a 4 or 5 stars accommodation facility in the Republic of Albania, certified as such by the responsible authority provided for under the Law.

The investment value is at least EUR 8 million for the construction of a 4 stars accommodation facility and at least EUR 15 million for the construction of a 5 stars one.

Në lidhje me kriteret e tjera, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë subjektet përkatëse për qëllime aplikimi për marrjen e statusit special në fjalë, autorizohet Këshilli i Ministrave për përcaktimin e tyre brenda një periudhe 9 (nëntë) mujore nga data e hyrjes në fuqi të Projektligjit (pas miratimit të tij nga Kuvendi).

Gjithashtu, të gjithë subjektet, që përfitojnë statusin special në fjalë, nënshkruajnë një marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për turizmin, e cila përmban detyrimet e ndërsjellta, afatet e realizimit, vlerën e projektit për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 ose 5 yje, ndalimet për tjetërsimin e pronësisë së këtyre strukturave, apo pjesëve të tyre, si dhe pasojat nga mosrespektimi i detyrimeve të ndërsjellta.

With regard to other criteria, procedures and documentation to be completed by the respective entities for purpose of application for obtaining the mentioned special status, they shall be determined by the Council of Ministers within 9 (nine) months from the date of entry into force of the Draft Law (i.e. following its approval from the Parliament).

Additionally, all entities, benefiting the special status, shall execute an agreement with the ministry responsible for tourism, containing the mutual obligations, terms of realization, value of the project on construction of the 4 or 5 stars accommodation facility, prohibitions for the alienation of the property titles over such facilities, as well as the consequences in case of breach of mutual obligations.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services

Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit

Gjeologji Miniera

Tirana | Albania

Mob: +355 68 60 33 116

E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 225,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.